

Besniku ka qenë pjesëtar UÇK-së. Në datën **26.08.1998**, nga ora 23:00. Besniku po kthehej me kushëririn Misinin nga pozicionet e UÇK-së. Përderisa po kalonin me makinë nëpër fshatin **Tërdec/Trdevac**, pjesëtarë të forcave serbe shtënën në drejtim të tyre. Që të dy u plagosën, por ia dolën që të largoheshin dhe të skajoheshin në një pyll të afërt. Atje i ka gjetur komandanti i UÇK-së Shpati, i cili i ka çuar në ambulancën e UÇK-së në Likoc/Likovac. Pas katër orësh, Besniku ndërroi jetë nga plagët e rënda. U varros në varrezat e fshatit të lindjes së Negrocit/Negrovce më 27.08.1998. Pas përfundimit të luftës, më 5.09.1999, mbetjet mortore të Besnikut janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovce.

Burimet: deklarata A.K, FDH-31845; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Islam (Xheladin) Mehmeti

(1933, shqiptar nga Fushtica e Poshtme/Donja Fuştica, komuna e Glllogocit/Glogovac, bujk)

Forcat serbe e kanë sulmuar fshatin **Fushticë të Poshtme/Donja Fuştica** më 20.08.1998. Po atë ditë, familja e Islamit u zhvendos në fshatin Nekoc/Nekovce. Islami ka mbetur në shtëpi, duke u thënë familjarëve që së shpejti do t'j bashkëngjitej atyre. Por nuk erdhi atë ditë. Familjarët nuk kishin më kurrfarë njohurish për të deri në datën 4.09.1998, kur Mehmeti, vëllai i Islamit, u takua me bashkëfshatarin e tyre Bislim Osmanin, i cili i ka rrëfyer për vrasjen e Islamit. Që të dy ata, Islami dhe Bislimi, më **28.08.1998**, rastisën të ishin afro 50 metra larg shtëpisë së Islamit, kur pjesëtarë të forcave serbe hapën zjarr ndaj tyre. Islamit e kanë qëlluar për vdekje në vend, përderisa Bislimin e kanë zënë peng, e kanë keqtrajtuar fizikisht për një kohë dhe, në fund, e kanë liruar. Në datën 11.09.1998, Mehmeti e ka gjetur trupin e Islamit në vendin ku atë e kishin vrrarë. Në gjoks i kishte disa plagë nga plumbat. Po atë ditë, Islamit e kanë varrosur në varrezat në Fushticë të Poshtme/Donja Fuştica.

Burimi: deklarata M.M, FDH-17979.

Sylë (Imer) Ramaj

(5.05.1923, shqiptar nga fshati Carravikë/Cerovik, komuna e Klinës/Klina, bujk, tetë fëmijë)

Në muajin prill të vitit 1998, kur forcat serbe e sulmuan fshatin Carravikë/Cerovik, Syla, së bashku me të bijtë dhe banorë të tjerë, e braktisi fshatin dhe u strehua në **Dobroshec/Dobroševac**. Atje i ngritën tendat, në të cilat qëndruan për pesë muaj rresht. Në fillim të muajit shtator të vitit 1998, forcat serbe e sulmuan edhe Dobroshec/Dobroševac. Shumica e fshatarëve i braktisën shtëpitë, ndërkaq të zhvendosurit i braktisën tendat duke u strehuar në pyjet përreth fshatit. Syla ka mbetur në tendën e tij, sepse ishte i palëvizshëm. Djemtë e tij shikonin nga pylli dhe kanë qenë dëshmitarë direkt [**6.09.1998**], kur ushtarët serbë ia kanë vënë zjarrin tendës, në brendi së cilës gjendej Syla. Pas tërheqjes së forcave serbe, djemtë e Sylës, Manushi dhe Salihu, shkuan te tenda e djegur të të atit. E gjetën atë në gjendje shumë të rëndë. Ishte i gjallë, por me djegiet e rënda në këmbët. E bartën në shpinë, së pari në fshatin Sllatinë/Slatina [Fushë Kosovë/Kosovo Polje]. Pastaj, e çuan me një veturë taksit në Matičan/Matičane [Prishtinë/Priština]. Syla ka ndërruar jetë nga plagët e rënda në datën 13.09.1998. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e lagjes *Dragodan* në Prishtinë/Priština. Në datën 2.12.2003, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Sylës në Cerrovikë/Cerovik [Klinë/Klina].

Burimet: deklarata I.R, FDH-19312; deklarata S.K, FDH-26793.

Hazir (Qerim) Avdyli

(1943, shqiptar nga Dobrosheci/Dobroševac, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, katër fëmijë)

Haziri u nis në punë në mihjen sipërfaqësore *Bardhi i Madh/Veliki Belačevac* [Fushë Kosovë/Kosovo Polje/], më **21.09.1998**. Para se të shkonte, u tha familjarëve që do të kthehej te farefisi në Vushtrri/Vučitrn pas mbarimit të ndërresës së tij, dhe se ata nuk duhej ta prisnin në shtëpi atë